



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

Ac.nr.1161/2019

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Arsim Hamzaj - kryetar i kolegjit, Frosina Sylejmani e Burim Shala - anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Z.M. nga Skenderaji rr.“...” nr..., të cilin me autorizim e përfaqëson av.Q.R. nga Skenderaji, kundër të paditurës Komuna e Skenderajit - Drejtoria Komunale për Arsim, të cilën me autorizim e përfaqëson Enver Qerkini, për shkak të kompensimit të pagave përcjellëse në pension dhe shpërblimit jubilar, duke vendosur sipas ankesës së paditësit të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - dega në Skenderaj, C.nr.447/18, të datës 24.01.2019, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datën **20.09.2021**, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

**I. APROVOHET e themeltë** ankesa e paditësit Z.M. nga Skenderaji, **NDRYSHOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë - dega në Skenderaj, C.nr.447/2018, të datës 24.01.2019, në pikën **III (tre)** të dispozitivit të tij dhe i njëjti gjykohet si në vijim:

- **Detyrohet** e paditura Komuna e Skenderajit - Drejtoria Komunale për Arsim, që paditësit Z.M. nga Skenderaji,, t'ia paguajë shpenzimet procedurale në lartësi prej **672.00€**, të gjitha këto në afatin prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit.

**II. Pika I (një)** dhe **II (dy)** e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - dega në Skenderaj, C.nr.447/2018, të datës 24.01.2019, mbetet e pashqyrtuar.

### A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar, C.nr.447/2018, të datës 24.01.2019, në pikën **I (një)** të dispozitivit, e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit Z.M. nga Skenderaji. Në pikën **II (dy)** të dispozitivit, e ka detyruar të paditurën që në emër të pagave jubilarë t'ia paguajë paditësit shumën e përgjithshme prej 1,197,99€, me kamatë ligjore si për mjetet e deponuara në bankat e Kosovës pa destinim të caktuar nga data e gjykimit 24.01.2019, deri në pagesën definitive,

të gjitha në afat prej 7 ditëve nga dita e marrjes së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit. Në pikën **III** (tre) të dispozitivit e ka detyruar të paditurën që paditësit t'ia paguajë edhe shpenzimet procedurale në shumë prej 269.00€, më gjerësisht si në aktgjykimin e atakuar.

Kundër këtij aktgjykimi përkatësisht pikës **III** të dispozitivit paditësi në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar të njëjtin për shkak të *shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, sa i përket shpenzimeve të procedurës*, me propozim që gjykata e Apelit ta prishë dhe të vendos në lidhje me pretendimet e paditësit.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës të nenit 194 dhe 195, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- Ankesa e paditësit është e **themeltë**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi me datë 15.02.2018, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi paditësi kundër të paditurës për shkak të moshës së pensionimit ,dhe shpërblimin jubilar. Fillimisht gjykata e shkallës së parë e ka hedhur poshtë si të paafatshme padinë e paditësit. Lënda sipas ankesë së paditësit është kthyer në rigjykim nga ana e Gjykatës së Apelit me aktvendimin Ac.nr.3425-18, të datës 29.10.2018.

Në rigjykim gjykata e shkallës së parë ka nxjerrë aktgjykimin C.nr.447/18, të datës 24.01.2019 me të cilën e ka aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit duke e detyruar të paditurën që në emër të pagave jubilarë t'ia paguajë paditësit shumën prej 1,197.99€. Ndërsa e ka detyruar të paditurën që paditësi t'ia paguajë edhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 269.00€. Në arsyetim të aktgjykimit përveç tjerash, sa i përket shpenzimeve të procedurës (pasi që kjo pjesë është atakuar me ankesë) ka theksuar se shumën për një seancë të mbajtur prej 135.00€, për taksa gjyqësore për ankesë prej 30.00€, dhe për ankesë në shumë prej 208.00€, e ka refuzuar pasi që të njëjtat janë krijuar me lëshimet e të autorizuarit të paditësit i cili nuk e ka prezentuar me kohë provën - dëshmin për të cilën lënda është kthyer në rigjykim.

Gjykata e shkallës së parë, ka nxjerrë aktgjykimin C.nr.447/2018, të datës 24.01.2019, me të cilën e ka Aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke e detyruar të paditurën, Komuna e Skenderajt - Drejtoria komunale për Arsim në Skenderaj, që duke u bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë, e cila ka hyrë në fuqi dhe në zbatim nga data 19.04.2017, ka për obligim për përmbushjen e detyrimeve pra paditësit në këtë rast, që në mënyrë solidare te 'ia paguajnë paditësit shumën e përgjithshme siç është cekur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit duke u bazuar nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, për shkak se aktvendimi

i atakuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.1, lidhur me nenin 453 par.1 dhe 2 të LPK-së.

Në këtë kuptim kolegji i kësaj gjykate vlerëson se gjykata e shkallës së parë, poashtu gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale kur ka vendosur sikurse në dispozitivin *III* të aktvendimit të atakuar, sepse gabimisht i janë llogaritur shpenzimet e procedurës palës paditëse. Kjo pasi që gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit ka theksuar se këto shpenzime janë krijuar me lëshimet e të autorizuarit të paditësit i cili nuk e ka prezentuar me kohë provën - dëshmin për të cilën lënda është kthyer në rigjykim, e që kjo nuk është e vërtetë sepse vet gjykata në arsyetim të aktgjykimit C.nr.46/18, të dates 04.05.2018 me të cilin e ka hedhur poshtë padinë (*edhe pse hudoja e padisë bëhet me aktvendim*) ka administruar si provë edhe dëshminë-provën: Vedimin Nr.143/17, të datës 28.04.2017, të lëshuar nga Drejtoria Komunale e Arsimit në Skenderaj me të cilin vendim paditësit i është njohur e drejta në tri paga përcjellëse për pension, që do të thotë se gjykata e ka pasur këtë provë edhe në procedurën e mëhershme. Poashtu në bazë të Rregullores së Odës së Avokatëve të Kosovës, të datës 18.03.2018, përkatësisht numrit tarifor 6 par.1 pika g) dhe numrit tarifor 7, për rastin konkret të paditurit i takojnë shpenzimet për përpilimin e përgjigjes në padi në shumë prej 104.00€, për dy seanca të mbajtura shumë prej 270.00€, për taksa gjyqësore për padi dhe ankesë shumë prej 60.00€, dhe për ankesë në shumë prej 208.00€. Andaj, Gjykata e Apelit ka vlerësuar se detyrimi i të paditurës për pagesën e shpenzimeve procedurale për paditësin është në shumë të përgjithshme prej 642.00€. Mbi këtë bazë, e duke e pasur parasysh rrethanat e cekura me lartë, Gjykata e Apelit vendosi si në pikën *I (një)*, të dispozitivit të këtij aktvendimi, përkatësisht e ndryshoj atë sa i përket lartësisë së shumës në emër të shpenzimeve procedurale.

Gjykata e Apelit vendosi si në pikën *II (dy)* të dispozitivit të këtij aktgjykimi të shkallës së dytë, meqënëse asnjëra nga palët ndërgjyqëse nuk ka paraqitur ankesë ndaj pikës *I (një)* dhe *II (dy)* të aktgjykimit të atakuar, që ka të bëjë me pjesën kryesore të aprovuar të kërkesëpadisë së paditësit, andaj kjo pjesë e dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë ka mbetur e pashqyrtuar.

Nga të gjitha arsyet e cekura në arsyetim të këtij aktgjykimi të shkallës së dytë, Gjykata e Apelit në mbështetje të dispozitave nga nenet 194 dhe 195, par.1, pika e), e lidhur me nenin 201 par.1 pika a) dhe nenit 453 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.1161/19, datë 20.09.2021**

**Kryetari i kolegjit - Gjyqtari**  
**Arsim Hamzaj**